

EUROPEAN DAYS OF LOCAL SOLIDARITY

www.localsolidaritydays.eu
#LocalSolidarityDays

15 → 30
Nëntor
2021

Informacion mbi Ditët Evropiane të Solidaritetit Lokal

Fushata

Qytetet dhe rajonet po udhëheqin rrugën drejt zhvillimit të qëndrueshëm global! Si? Falë projekteve të tyre të bashkëpunimit ndërkombëtar, me qytete dhe rajone në të gjithë planetin, si dhe menaxhimin e sfidave të përditshme duke u orientuar nga zgjidhjet që kanë të bëjnë me qëndrueshmërinë. **Ditët Evropiane të Solidaritetit Lokal (EDLS)** u bëjnë thirrje qyteteve dhe rajoneve evropiane për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve të tyre, mbi sfidat e zhvillimit të qëndrueshëm global dhe për nevojën për të ndërmarrë veprime konkrete.

Mos mungoni në Edicionin e vitit 2021, që do të zhvillohet nga 15 deri në 30 nëntor në të gjithë Evropën.

Mesazhet kyçe

Qytetet dhe rajonet evropiane forcojnë njohuritë e qytetarëve për çështje globale të zhvillimit të qëndrueshëm.



AKSIONI!

Qytetet dhe rajonet evropiane forcojnë njohuritë e qytetarëve për çështje globale të zhvillimit të qëndrueshëm. Organizoni ose promovoni ngjarje publike që synojnë të informojnë dhe diskutojnë rreth sfidave të zhvillimit të qëndrueshëm global, si dhe rëndësinë e solidaritetit, duke vënë theksin në përvojën e qytetit tuaj në projekte të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Qytetet dhe rajonet evropiane mbështesin dhe promovojnë edukimin mbi zhvillimin dhe nismat aktive qytetare, me ndikim të madh lokal.



AKSIONI!

Bashkëpunoni me organizatat lokale të shoqërisë civile (OSHC), grupe qytetarësh ose qendra arsimore për të organizuar dhe mbështetur fushatat e ndërgjegjësimit, ngjarje publike ose nisma trainimi, që kontribuojnë fuqimisht në angazhimin aktiv të qytetarëve dhe sensin e solidaritetit.

Qytetet dhe rajonet evropiane promovojnë angazhimin politik në shkallë kombëtare, evropiane dhe globale, në favor të zhvillimit të qëndrueshëm.



AKSIONI!

Fuqizoni dialogun midis kryetarëve të bashkive dhe përfaqësuesve lokalë në të gjithë Evropën dhe promovoni shkëmbimet me vendim-marrësit kombëtarë dhe globalë, mbi ndikimet pozitive të solidaritetit dhe bashkëpunimit "të decentralizuar", në zhvillimin e qëndrueshëm lokal dhe global.



#LocalSolidarityDays

Implica-ti orasul sau regiunea in initiativa!

Planifika aktivitetin tuaj të Ditëve Evropiane të Solidaritetit Lokal (EDLS), midis datave 15 dhe 30 Nëntor 2021.

Një aktivitet EDLS është:

- I organizuar ose bashkë-organizuar nga një qytet ose rajon i Evropës, apo nga një shoqatë e qeverive lokale dhe rajonale;
- Një mundësi për qytetarët, zyrtarët e zgjedhur ose zyrtarë lokalë, rajonalë, OSHC-të dhe aktorët e tjerë lokalë për të mësuar, shkëmbyer, diskutuar dhe festuar;
- I përqëndruar në kontributin e qyteteve dhe rajoneve evropiane për zhvillimin e qëndrueshëm global, me vëmendje të veçantë në bashkëpunimin e tyre ndërkombëtar dhe partneritetet qytet-me-qytet.

Gjatë 2021...

Më shumë se

70

bashki,
rajone dhe krahina
evropiane

organizuan

60

ngjarje gjatë

2

javëve

me më shumë se

20

zyrtarë të zgjedhur
vendorë dhe Anëtarë
të Parlamenteve

Bashkojuni fushatës!

- Përdorni logon e EDLS në materialet tuaja për të fuqizuar iniciativën tuaj dhe për të forcuar mesazhet kryesore të saj. Aktiviteti gjithashtu do të promovohet përmes faqes së Internetit të EDLS (localsolidaritydays.eu) dhe fushatës në Twitter ([#localsolidaritydays](https://twitter.com/localsolidaritydays)).
- Firmosni Aktin themelues të EDLS për të zyrtarizuar angazhimin e qytetit tuaj me vlerat e përbashkëta të demokracisë, solidaritetit, bashkë-përgjegjësisë dhe partneritetit. Mbështetja e homologëve tuaj evropianë gjithashtu mund të përmirësojë njohjen e mëtejshme politike dhe sociale të angazhimit të qytetit tuaj, për zhvillim të qëndrueshëm global. Ju mund ta firmosni Aktin Themelues të EDLS duke klikuar më poshtë (në Udhëzimin keni edhe hapat që duhet të ndiqni): localsolidaritydays.eu/edls-charter
- Bëhuni pjesë e një komuniteti të qyteteve evropiane dhe shkëmbimit rajonal, mësoni dhe diskutoni rregullisht për mjetet e ndërgjegjësimit, edukimin mbi zhvillimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm nga një këndvështrim lokal.

Për info të mëtejshme
www.localsolidaritydays.eu



Na kontaktoni në
platforma@ccre-cemr.org



Postoni në Twitter
[#LocalSolidarityDays](https://twitter.com/LocalSolidarityDays)



Ditët Evropiane të Solidaritetit Lokal janë të organizuar nga PLATFORMA, koalicioni pan-Evropian i qyteteve dhe rajoneve dhe shoqatat e tyre të përfshira në bashkëpunimin për zhvillim qytet-me-qytet. Kjo iniciativë është zhvilluar në kuadër të Marrëveshjes së Partneritetit Strategjik të nënshkruar midis CEMR-PLATFORMA dhe Komisionit Evropian. Ajo bashkëfinancohet nga Bashkimi Evropian.